



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

- Njoftim për mediumet-

Shkup, 07.04.2023

### Politikat për zhvillim të barabartë rajonal nuk japin rezultatet e pritura

Edhe përkundër aktiviteteve të ndërmarra në nivel qendror dhe rajonal në vitet e mëparshme, pabarazitë socio-ekonomike dhe demografike ndërmjet dhe në kornizat e rajoneve planifikuese nuk janë ulur

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksesit me temë „**Zhvillimi i barabartë rajonal me theks të veçantë të demografisë**” në pajtim me Programin Vjetor të punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022, për t’iu përgjigjur pyetjes: „ **A siguron sistemi i menaxhimit të politikave për zhvillim të barabartë rajonal zvogëlimin efektiv të pabarazive brenda dhe ndërmjet rajoneve planifikuese dhe kohezionit të tyre përkatës demografik, ekonomik, social dhe hapësinor?**”

**Politikat për nxitje** e zhvillimit të barabartë rajonal zbatohet nëpërmjet dokumenteve planifikuese dhe programore, me miratimin dhe **përditësimin** e tyre **në kohë** në pajtim me rezultatet nga zbatimi i Regjistrimit të popullatës në vitin 2021.

Me revizionin është konstatuar se **Strategjia për zhvillim rajonal në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2031** është miratuar **me vonesë**, bazuar në **vlerësim** për popullsinë, e cila **devijon** nga rezultatet e Regjistrimit.


Për nxitje të zhvillimit të barabartë rajonal nga Buxheti i shtetit duhet çdo vit të ndahen më së paku **1% nga PBV**, të cilat për financimin e projekteve shpërndahen sipas planeve rajonale, në pajtim me **Vendimin për klasifikimin e rajoneve planifikuese dhe shkallën e zhvillimit**.

Me revizionin është vërejtur **trendi i rritjes** së mjeteve të ndara për këtë dedikim në vitet e fundit, por të njëjtit **nuk janë në nivelin** e përcaktuar me ligj.

Në periudhën **2019-2021**, nga Buxheti i shtetit, në funksion të zhvillimit të barabartë rajonal, janë ndarë mjete në shumën totale për rreth **9 miliard denarë**, që paraqet **46%** nga minimumi i përcaktuar me ligj, ndërsa janë shfrytëzuar **83%** gjegjësisht rreth **8 miliard denarë**.



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËTOR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE



Shpërndarja e mjeteve sipas rajoneve **nuk është kryer** në pajtim me shkallën e përcaktuar të zhvillimit.

Me revizionin është konstatuar zbatimi jo konsekuent i indeksit të zhvillimit gjatë shpërndarjes së mjeteve në të gjitha rajonet. Përkatësisht, **rajoni i Shkupit si më i zhvilluari**, edhe pse duhet të merr pjesë me **7,2%**, ndërsa **rajoni Verilindor si më pak i zhvilluar** me **17,3%** nga mjetet totale buxhetore për këtë dedikim, në rajonin e Shkupi janë ndarë **26,2%**, për dallim nga rajoni i Verilindjes që mori **8,4%**.

Gjithashtu, janë konstatuar **dobësi dhe funksionalitet jo i plotë** i sistemit **SuReRa** si një platformë e integruar softuerike e cila **jep mundësi** për koordinim të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave për nxitje të zhvillimit të barabartë rajonal.

Edhe përkundër aktiviteteve të ndërmarra në nivel qendror dhe rajonal në vitet e mëparshme, **pabarazitë socio-ekonomike dhe demografike** ndërmjet dhe në kornizat e rajoneve planifikuese **nuk janë ulur**.


Shtimi natyror i popullsisë si indikator i rëndësishëm për përcaktimin e indeksit demografik, nga viti 2010 në vazhdimësi shënon rënie, gjegjësisht për 2,5%, i njëjti në vitin 2021 ka parashenjë negative dhe është **-5,4%**. Trend të uljes së shkallës së rritjes natyrore shënojnë të gjitha rajonet, ndërsa **më e ulëta në rajonin Lindor dhe të Palagonisë**.

Kjo gjendje plotësohet nga rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë të zbatuar në vitin 2021, të cilët tregojnë se dy rajonet (rajoni i Vardarit dhe Juglindjes) nuk i plotësojnë kriteret për numrin minimal të popullsisë sipas Nomenklaturës së njësisë territoriale për statistikë (NNJTS3) nga 150.000 banorë, ndërsa rajoni Lindorë është në kufirin e minimumit të përcaktuar.

*Trendi i shkallës së rritjes natyrore sipas rajoneve*



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHKETËTOR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE



Burim i të dhënave: Enti Shtetëror i Statistikave, baza MAKStat e të dhënave

Në **dhjetë vitet** e fundit **migrimet** e jashtme kanë kryesisht bilanc negativë, ndërsa **më së shumti** janë regjistruar persona të shpërngulur në rajonet e Pollogut, Vardarit dhe rajonin Jugperëndimor.



Burim i të dhënave: Enti Shtetëror i Statistikave, baza MAKStat e të dhënave. Popullsia

Trendi i migrimeve të popullsisë nga fshatrat çon deri te braktisja e tyre. Sipas rezultateve nga zbatimi i **Regjistrimit të popullsisë në vitin 2021**, në shtet ka **205 vendbanime/fshatra** të braktisura dhe në krahasim me **vitin 2002** numri i tyre është rritur për **40%**, gjegjësisht edhe **58 fshatra kanë mbetur pa asnjë banor**.

Nga BPV total i Republikës së Maqedonisë së Veriut, **43%** krijohet në **rajonin e Shkupit** që është më shumë se **8 herë** nga BPV në **rajonin Verilindor** i cili në totalin e BPV merr pjesë me vetëm **5%** dhe ka nivel më të lartë të **papunësisë prej 32,4%**.

Revizioni i kryer dhe indikatorët e analizuar të rajoneve, sugjerojnë se aktivitetet e realizuara dhe mjetet e shfrytëzuara për realizimin e qëllimeve strategjike, nuk kanë arritur uljen e pabarazive ndërmjet rajoneve planifikuese në shtet.



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

**Dallimet** e konstatuara rajonale **në zhvillimin socio-ekonomik**, sugjerojnë për planifikim joefikas të aktiviteteve për realizimin efektiv të politikës për zhvillimin e barabartë rajonal, me çka **është e nevojshme** revidimi i masave të parapara në nivel nacional, lokal dhe rajonal dhe veprim i koordinuar për uljen e pabarazive, **rritjen e atraktivitetit** të rajoneve dhe **cilësinë e jetës së popullsisë**.

Press kontakt:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72228 203 [albiona.mustafa@dzr.gov.mk](mailto:albiona.mustafa@dzr.gov.mk)

Mijalçe Durgutov +389 70 358 486 [mijalce.durgutov@dzr.gov.mk](mailto:mijalce.durgutov@dzr.gov.mk)

Martin Duvnjak +389 75 268 517 [martin.duvnjak@dzr.gov.mk](mailto:martin.duvnjak@dzr.gov.mk)